



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.27, datë 14.12.2022

PËR

MIRATIMIN E “KËRKESË PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”, SUBJEKTIT “GRUPPO KONI” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare (Shitje materiale ndërtimi) me Nr.serie:0057, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.9, datë 22.09.2017, subjektit “Gruppo Koni” sh.p.k, me vendndodhje, autostrada Lezhë-Tiranë, bashkia Lezhë, qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- X=471880

- Y=4620415

- Z=15 m.m.n.d

- Prurja mesatare : $Q_{mes} = 2 \text{ l/s}$

- Sasia e ujit në përdorim : $Q = 0,3 \text{ l/s}$

- Qëllimi i përdorimit : Ujë sanitar për qëllimet e biznesit (Shitje materiale ndërtimi)

- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

